



Seb. France  
21/01/2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
Tiranë, Më

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

Nr. 10487/4 prot.

Tiranë, më 30.12.2021

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe reagimet për auditimin.

**AGJENCISË RAJONALE TË EKSTENSIONIT BUJQËSOR**

**Tiranë**

Bashkangjatur po Ju dërgojmë Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushruar në Institucionin Tuaj nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” , kapitulli VI, pika 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm , miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, detyroheni që Raporti të jetë objekt analize në strukturat tuaja.

**Brenda 30 ditëve** duhet të dërgoni Planin e Veprimit të plotësuar me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit dhe reagimet për auditimin sipas formularit bashkëlidhur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

## RAPORT PËRFUNDIMTAR

AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT  
BUJQESOR TIRANË

Periudha e audituar

(DERI MË 30.09.2020)

Tiranë, Dhjetor 2020

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

AREB Tiranë është institucion buxhetor i krijuar me VKM Nr. 147, datë 13.3.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor financohen nga buxheti i shtetit, i miratuar për ministrinë përgjegjëse. AREB Tiranë përfshin qarqet Durrës, Tiranë dhe Dibër. Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor kanë si mision të tyre të bëhen faktorë kryesorë në zhvillimin e sektorit bujqësor, konkurrues dhe të qëndrueshëm në vend, të ofrojnë informacion dhe këshillim për zhvillimin teknik e teknologjik të fermave bujqësore, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi, të ofrojnë informacion dhe të asistojnë fermerët për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, IPARD-i dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, të nxisin dhe të ndihmojnë krijimin e funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve etj. Të organizojnë dhe të kryejnë trajnimin profesional të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, të sigurojnë informacion për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografikë etj. Të informojnë dhe të këshillojnë fermerët për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive e të pajisjeve bujqësore. Aktiviteti i AREB Tiranë financohet nga buxheti i shtetit. AREB Tiranë, për përmbushjen e objektivave në fushën e shërbimit të këshillimit bujqësor bashkëpunon me AREB-ct e Qarqeve, ESIIF, AZIIBR etj.

Grupi i auditimit ushtroi auditim mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm për parandalimin e krijimit të detyrimeve financiare ndër vite deri në 30.9.2020, risqet e përgjithëshme, identifikimi i mangësive, ndërmarja e veprimeve korrigjuese.

Gjetjet e trajtuara në raport janë sipas sistemeve/fushave të audituara në fund të çdo pike të Raportit, sipas programit/drejtimeve të auditimit, të vlerësuar me impaktin/ndikimin dhe rëndësinë e çdo gjetje dhe rekomandimin përkatës për përmirësim. Rekomandimet jepen në aneksin Nr.1 në përgjigje të gjetjeve të konstatuara, bashkëlidhur këtij raportit.

### I. HYRJE

Në zbatim të nenit 68 të ligjit 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 477 datë 19.11.2020 dhe shkresës së lajmërimit nr. 10884 datë 09.12.2020, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” u krye auditim i plotë për periudhën deri më 30.09.2020

*Takimi fillestar* u zhvillua në datën 09.12.2020 me Drejtorin e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë Z.Veis Selami, Përgjegjësën e Sektorit të Financës znj. Znj. Drita Nikoçi, Përgjegjësën e grupit të auditimit z. Reshit Haka, audit dhe Znj. Adriana Nasi, specialiste e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MBZHR.

U prezantua qëllimi, programi i punës, tematika, objektivat e auditimit. Palët ranë dakort për fillimin e misionit të auditimit dhe kushtet e punës.

*Qëllimi i auditimit* është vlerësimi i sistemeve:

- ✓ të kontrollit të brendshëm: sistemi i kontrollit të buxhetit, i menaxhimit të riskut në arritjen e objektivave kryesorë sipas sektorëve.

- ✓ të menaxhimit financiar: sistemi i kontabilitetit, i pagesave, të ardhurave, i prokurimeve, i aktiveve.
- ✓ të menaxhimit të burimeve njerëzore: respektimi i strukturës organike të miratuar, administrimi i dosjeve personale, ruajtja sipas rregullave, regjistri themeltar i punonjësve, hartimi/realizimi i objektivave, vlerësimi i performancës së punonjësve, mbajtja, përpunimi dhe shfrytëzimi i dokumentacionit në arkivë.

Në përfundim të misionit të auditimit, mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga vlerësimi i të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë audituese, u hartua akti i verifikimit i datës 11.12.2020 i cili ju vu në dispozicion Institucionit në formë elektronike dhe i printuar me datë 28.12.2020.

Me shkresën e AREB Tiranë 1060/1 prot. datë 29.12.2020 u mor reagimi për gjetjet, rekomandimet dhe Planin e Veprimit të sugjeruar nga auditimi, të nënshkruar pa vërejtje.

**III. Metoda e auditimit:** është me bazë në sistem. U përzgjedhën:

1. *Metoda e intervistimit*, në njohjen e proceseve dhe funksionimin e Institucionit.
2. *Metoda e përdorimit të pyetësorëve*, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion.
3. *Metoda e testimit të detajuar*, ekzaminimi i dokumentacionit sipas objektivave të auditimit.
4. *Metoda e rindërtimit të ngjarjeve*, mbështetur në radhën kronologjike të dokumentacionit - veprime.
5. *Metoda e ndjekjes së dokumentacionit*, gjurmim dokumentacioni sipas rrjedhës/modelit standart.
6. *Metoda e rishikimit analitik*, rishikimi i dokumentacionit deri tek dokumentacioni fillestar.

**Teknikat e auditimit.** Për të arritur në konkluzione profesionale, janë kombinuar teknikat e përdorura:

- ✓ *sondazhe në kohë* për ekzaminimin e periudhave të caktuara
- ✓ *sondazhe për operacione* të cilave u është ndjekur gjurma nga fillimi në fund.
- ✓ *Testimi 100%* në pagesat e kryera,
- ✓ *Shqyrtimi i dokumentave* listëpagesa, proces verbaleve të komisionit, faturat, regjistrat e kontabilitetit dhe
- ✓ *Vlerësimi* i dokumentacionit, *Informacione verbale* të marra nga drejtuesi, punonjësit e tjerë të MBZHR.

#### **IV. GJETJET DHE KONKLuzionET**

Auditimi u krye në përputhje me programin e miratuar, për periudhën 30.09.2019 sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe në mënyrë të përmbledhur gjetjet janë si më poshtë:

#### **DREJTIMET E AUDITIMIT:**

##### **I. Përputhshmëria e zbatimit të buxhetit.**

**1. Vlerësimi paraprak i lindjes së detyrimeve financiare të prapambetura.** Klasifikimi i tyre sipas standarteve të kontabilitetit publik dhe kohës së krijimit të detyrimeve për çdo kategori.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2019, situacionit të shpenzimeve të vitit 2020, 9 mujorit, të raportit 4-mujor të zbatimit dhe të monitorimit të buxhetit, të ditarit të bankës regjistrit të

parashikimit dhe të realizimit të prokurimeve publike, (realizimi) deri më 30 shtator 2020, u konstatua se AREB Tiranë nuk rezulton me detyrime financiare të prapambetura. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2019, rezulton se detyrimet në pasiv të pasqyrave financiare rezultojnë për **5.024.841 lekë dhe përfaqësojnë:**

- Llogaria 42 Detyrime ndaj personelit në shumën 3.558.763 lekë, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2019, të cilat janë likuiduar në Janar të vitit 2020.
- Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit, tatim taksa” për shumën 220.447 lekë, përfaqëson detyrimin mbi pagë të muajit dhjetor të vitit 2019, të likuiduara në Janar 2020.
- Llogaria 436 “sigurime shëndetësore” në shumën 146.87 lekë përfaqëson sigurimet shoqërore të përlllogaritura nga pagat e muajit Dhjetor 2019, të likuiduara në Janar 2020.

Gjatë vitit 2019 dhe 2020, AREB Tiranë nuk ka bërë vlerësim paraprak të lindjes së detyrimeve financiare për shkak se nuk ka konstatuar detyrime financiare të prapambetura dhe nuk ka financuar fonde për këtë qëllim. Areb Tiranë në planin e financimit është përqëndruar në mbështetjen financiare të programit 04860 dhe kryesisht financimin e aktivitetit të shërbimit këshillimor, në financimin dhe mbështetjen me fonde të shërbimeve, mirëmbajtjes, mallrave etj.

Për vitin 2019 dhe 2020, Areb Tiranë është financuar

AREB Tiranë, për vitin 2019, është financuar në shumën 57.949 mijë lekë dhe në vitin 2020 është financuar për shumën 65.195 mijë lekë si më poshtë:

Në 000/lekë

EMËRTIMI	ARTIKULLI BUXHETOR	VITI 2019		VITI 2020	
		Plan	Fakt	Plan vjetor	Fakt 9 mujor
Paga	600	37.000	36.557	45.000	29.713
Sigurime shoqërore	601	7.100	6.409	7.500	4.964
Paga vrojtuesit	600	1.466	1.466	583	583
Sigurime shoqërore, vrojtuesit	601	245	245	97	97
Shpenzime operative	602	9.900	9.354	10.000	6.457
Shpenzime operative, vrojtuesit	602	142	142	593	0
Transfertë familjare	606	177	177	87	0
Investime	231	960	618	1.500	0
Investime	231	960	669	0	0
Shërbim	606	0	0	227	227
<b>TOTALI:</b>		<b>57.949</b>	<b>55.495</b>	<b>65.195</b>	<b>42.041</b>

#### Viti 2019

Sa më sipër rezulton se Areb Tiranë, nuk është financuar për likuidimin e detyrimeve financiare të prapambetura. Realizimi i fondeve paraqitet:

Fondi i pagave, buxheti -443 mijë lekë, ose 98.8 % e planifikimit

Fondi i sigurimeve shoqërore, buxheti -691 mijë lekë, ose 90.2 % e planifikimit

Fondi i shpenzimeve operative, buxheti -546 mijë lekë, ose 94.5% e planifikimit etj

**9 mujori 2020**

Siç rezulton realizimi i fondeve për vitin 2020(9-mujori) rezulton për -13.154 mijë lekë, ose 64% e planifikimit. Të dhënat për vitin 2020, si për planifikimin ashtu dhe për realizimin i përkasin 9-mujorit, realizimi i fondeve është në proces. Mos realizimi vjen: për pagat dhe sigurimet si pasojë e mos plotësimit të organikës, për shpenzimet operative nga mos realizimi i fondit të prokurimeve publike, për shkak të pezullimit të procedurës së prokurimit nga pandemia. Mos realizimi i investimeve vjen nga mos realizimi i procedurës së prokurimit nga AKSHI. Realizimi është bërë në Nëntor 2020, në shumën prej 1.161 mijë lekë, kjo perfaqëson vlerën përfundimtare të realizimit të fondeve për investime, prokurim i cili është realizuar nga AKSHI në muajin Tetor, likujduar në muajin Nëntor 2020. Referuar sa më sipër rezulton se Areb Tiranë, nuk është financuar për likuidimin e detyrimeve financiare të prapambetura.

#### **Realizimi i fondeve, 9-mujori i detajuar paraqitet:**

Fondi i pagave, -4.387 mijë lekë, ose 87 % e planifikimit

Fondi i sigurimeve shoqërore, -836 mijë lekë, ose 85.5 % e planifikimit

Fondi i shpenzimeve operative, buxheti -2000 mijë lekë, ose 80 % e planifikimit etj

Realizimi i fondeve është në proces. Theksojmë se plani 9-mujor(Plani i Thesarit) i financimit të AREB Tiranë është 50.595 mijë lekë

Referuar sa më sipër për vitin ushtrimor 2019 dhe 2020 (deri në 30 Shtator), nuk janë akorduar fonde për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura, për shkak se nuk janë konstatuar të tilla. Nga auditimi rezulton se në të gjithë programet e auditimit të MBZHR shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura (borxhet), është vendosur pikë më vete, si edhe kjo pikë është vlerësuar me rrisht duke i kushtuar mjaft rëndësi.

## **2. Evidentimi dhe rakordimi i të dhënave për kontratat, urdhërat e gjykatës apo zyrave të përmbarimit gjyqësor për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, të mbetura të papaguara mbi 60 ditë kalendarike nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik (lindjes së detyrimit), si dhe ato të afatit të pagesës së përcaktuar në marrveshje apo legjislacionin përkatës.**

### **Evidentimi dhe raordimi i të dhënave**

AREB Tiranë për periudhën objekt të auditimit nuk ka konstatuar detyrime financiare të prapambetura. Në rastin e konstatimeve AREB Tiranë ka bërë vlerësimin e shumës financiare që i detyrohet palëve të treta duke rakorduar të dhënat e kontratës, të dhënat e evidentuara në vendimin e gjykatës, në fatura, dokumentacionin që administron dega e financës dhe të dhënat nga zyrat përmbarimore.

### **Evidentimi dhe rakordimi**

Pas konstatimit të detyrimit financiar AREB Tiranë, ka bërë evidentimin dhe rakordimin e shumës së konstatuar dhe ka nisur procedurat e vlerësimit dhe shlyerjes së detyrimit financiar. Për këtë administrohen:

### **Likuidimi i detyrimeve financiare.**

Likuidimi i detyrimeve financiare të prapambetura nëpërmjet rishikimit gjatë vitit ushtrimor (2020) është bërë në dy raste dhe konkretisht:

**Urdhër shpenzimi nr. 18**, datë 27.01.2020, për shumën 1.098.544 lekë është likuiduar “BAILIFF” shpk për shpenzime gjyqësore dhe me urdher shpenzimi nr. **180, datë 13.08.2020** është likuiduar Zoti Shpetim Allamani, përmbarues, për llogari të kreditorit Dallandyshe Koleci,

në shumën prej 1.107.019 lekë, për shpenzime gjyqësore. Në total në vitin 2020 janë likuiduar 2.205.563 lekë

**urdhër shpenzimi nr. 18 datë 27.01.2020**

-Lajmërim për ekzekutim vullnetar i shoqërisë përmbarimore Hoti BALFIFF datë 12.12.2019

-Autorizim i MBZHR-së nr. 9712 datë 26.12.2019.

-Vendim i Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Durrës, Nr. Vendimi 391, datë 25.04.2017.

-Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë Nr. Vendimi 3082, datë 22.11.2019.

-Faturë tatimore nr. 239, shkresa për tarifën përmbarimore për shumën 119.844 lekë.

-Shkresa e AREB Tiranë nr. 34/1 prot. datë 23.01.2020, drejtuar MBZHR-së për **ndryshim regjistri**.

-Regjistri i parashikimit të prokurimit publik për vitin 2020

Printimi nga sistemi i fondeve për prokurim.

-Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 312, datë 15.01.2020, dërgim buxheti për vitin 2020 për AREB Tiranë.

-Pasqyra e raportimit periodik të realizimit të fondeve nga AREB Tiranë, për periudhën Janar-Dhjetor 2019.

-Pasqyra e raportimit periodik të realizimit të fondeve nga AREB Tiranë, për periudhën Janar-Shtator 2020.

**Urdher shpenzimi nr. 180 datë 13.08.2020**

-Autorizim për likuidim të vendimit gjyqësor nr. 6309, datë 03.08.2020.

-Kërkesa e AREB Tiranë, nr. 700/2 prot. datë 6.7.2020, drejtuar MBZHR-së për autorizim për likuidim të shpenzime gjyqësore.

-Lajmërim për ekzekutim vullnetar të vendimit gjyqësor, i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve nr. 214, datë 25.06.2020

-Vendim i Gjykatës Shkallës Parë Tiranë për likuidim detyrimi, nr. regjistri 1503, Nr. Vendimi 1345, datë 03.04.2017.

-Lajmërim i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve për ekzekutim vullnetar të detyrimit të vendimit gjyqësor, nga Drejtoria e Bujqësisë Dibër.

-Lajmërim për ekzekutim vullnetar të vendimit gjyqësor nr. 214 prot. datë 25.06.2020 i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve, Burrel për ekzekutim vullnetar.

Në të dy rastet Enti Prokurues AREB Tiranë ka shlyer detyrimin financiar përpara 60 ditëve dhe konkretisht:

**Hoti Balfiff**, përmbarues, për llogari të kreditorit Fatmir Gjeçi.

1. Lajmërim për ekzekutimin e likuidimin e Balfiff shpk nr. 4502, datë 11.12.2019.

2. Autorizim i MBZHR-së për likuidim nr. 9712/2 datë 26.12.2019, datë hyrëse në AREB Tiranë datë 6.01.2020.

3. Likuidimi i detyrimeve financiare me urdhër shpenzimi nr. 18, datë 27.01.2020, 32 ditë pas autorizimit të MBZHR, ose 22 ditë pas hyrjes dhe protokollimit në AREB Tiranë të dokumentacionit.

**Shpëtim Allamani**, përmbarues, për llogari të kreditorit Dallandyshe Koleci.

1. Kërkesë AREB Tiranë për likuidimin e Z. Shpëtim Allamani, përmbarues, nr. 700/2 datë 06.07.2020.

2. Autorizim i MBZHR-së, për likuidim detyrimi gjyqësor, nr. 6309, datë 3.8.2020.

3. Likuidimi i detyrimeve financiare me urdhër shpenzimi nr. 180, datë 13.08.2020, ose 10 ditë nga konstatimi i detyrimit.

Sa më sipër AREB Tiranë ka bërë likuidimin e detyrimeve financiare të konsatatuara në përputhje me dispozitat ligjore, brënda 60 ditëve nga autorizimi i lëshuar nga MBZHR dhe shuma e paguar rakordon me shumën sipas të dhënave të administruara në vendimin e gjykatës të formës së prerë, të zyrës përmbarimore dhe dokumentacionit që administrohet nga AREB Tiranë.

**Nga auditimi rezulton se për dy raste AREB Tiranë, ka likuiduar 2.205.063 detyrime gjyqësore, me urdhër shpenzimi nr 18 datë 27.01.2020 në shumën 1.098.544 lekë, sa likuiduar Hoti BALFIF dhe urdhër shpenzimi nr. 180, datë 13.08.2020, në shumën 1.107.019 lekë, likuiduar Shpëtim Allamani.**

**3. Verifikimi i regjistrit të prokurimeve për fondet publike, mallra shërbime, punë publike të depozituar pranë Degës së Thesarit, në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe ndaj çdo rishikimi të tij gjatë vitit ushtrimor.**

**Parashikimi i prokurimit të fondeve:**

**Viti 2020**

Nga verifikimi i regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike dhe realizimit të tij rezultoi se Enti Prokurues, mbeshtetur në financimin me fonde buxhetore dhe në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar pas parashikimit një kopjo të tij e ka dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë nr. 34/1 datë 23.01.2020 dhe MBZHR në fillim të vitit ushtrimor. Fondet e parashikuar për tu prokuruar rezultojnë për 13 procedura “Blerje me vlera të vogla” në shumën 5.190.000 lekë pa tvsh dhe 6.228.000 lekë me tvsh.

**Realizimi i prokurimeve publike deri më 30 Shtator 2020,** rezulton për 10 procedura prokurimi, me vlerë të kontraktuar në shumën 3.008.991 lekë me tvsh. Regjistri i realizimit të prokurimeve publike, me shkresën nr 823 prot. datë 08.09.2020, është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë, raportimi 4-mujor i realizimit të prokurimeve.

Me shkresë të AREB Tiranë nr. 271/4 datë 25.03.2020 është dërguar në MBZHR shtesë regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit publik për prokurimin me objekt “Blerje pajisje kompjuterike” me fond limit në shumën 1.250.000 lekë pa tvsh (1.500.000 lekë me tvsh). Kjo procedurë prokurimi është e përqëndruar dhe është realizuar nga AKSHI në shumën 1.161.120 lekë me tvsh.

Realizimi i fondeve për vitin 2020 është në proces.

**Rishikimi gjatë vitit ushtrimor.** Në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakesimet të cilat janë reflektuar edhe në parashikimin dhe realizimin përfundimtar të regjistrit të realizimit të prokurimeve publike. Në regjistrin e parashikimit dhe të realizimit të prokurimeve publike, nuk konstatohet shtesë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Sic e etheksuam më lart Enti Prokurues në dy raste ka ndërhyrë duke rishikuar objektet e prokurimit, për likuidim të vendimeve gjyqësore dhe ndryshim për blerje komuterike. Rishikimi ka ndodhur brënda vitit.

**Realizimi i fondeve:** Sipas regjistrit të realizimit të prokurimeve publike si 8 mujor, dërguar në MBZHR me shkresë nr. 823 prot. datë 8.09.2020 rezulton se janë prokuruar 3.333.000 lekë me



tvsh për 10 procedura prokurimi, realizuar në fakt 2.518.306 lekë pa tvsh, për 10 procedura.  
**Realizimi i fondeve është në proces, raportimi është 8-mujor.**

**Shpërndarje e barabartë e fondeve për prokurim dhe të afateve kohore të realizimit të kontratës.**

Subjekti i audituar	AREB Tiranë, nëpunësi autorizues zbatues
Njesitë, subjektet e interesuara nga gjetja	AREB Tiranë, MBZHR
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.</li> <li>• Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.</li> <li>• Udhëzimet vjetore për zbatimin e buxhetit të Shtetit.</li> </ul>
Përshkrim i gjetjes	<p><b>Situata:</b> Pas akordimit të fondeve AREB Tiranë, ka bërë detajimin e tyre .Fondet e parashikuar për tu prokuruar rezultojnë për 13 procedura “Blerje me vlera të vogla” në shumën 5.190.000 lekë pa tvsh dhe 6.228.000 lekë me tvsh.</p> <p>Në regjistrin e parashikimit dhe të realizimit të prokurimeve publike, nuk konstatohet shtesë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Enti Prokurues në dy raste ka ndërhyrë duke rishikuar objektet e prokurimit, për likuidim të vendimeve gjyqësore dhe ndryshim për blerje komuterike. Rishikimi ka ndodhur brënda vitit.</p> <p><b>Realizimi i fondeve:</b> Si 8 mujor, 2020rezulton se janë prokuruar 3.333.000 lekë me tvsh për 10 procedura prokurimi, realizuar në fakt 2.518.306 lekë pa tvsh, për 10 procedura. <b>Realizimi i fondeve është në proces, raportimi</b></p> <p><b>Kriteri:</b> Pika 3 dhe 4 e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar</p> <p><b>Ndikimi/efekti:</b> Nuk mundëson monitorimin efektiv të planifikimit dhe shpërndarjes së barabartë të fondeve për tu prokuruar.</p> <p>-Pamjaftueshmëri e burimeve njerëzore për ti angazhuat në përlllogaritjen e fondit limit, njësinë e prokurimit, komisionin e vlerësimit të ofertave, ndjekjen e kontratës, marjen në dorëzim të mallrave/materialeve a punëve publike</p> <p><b>Shkaku:</b> Nuk ka shpërndarje të barabartë të fondeve në katër mujore për tu prokuruar dhe të afateve kohore për realizimin e kontratës</p>
Niveli i riskut:	<b>i mesëm</b>
Konkluzioni	Për shkak të mos shpërndarjes së barabartë të fondeve dhe procedurave në 4-mujore, ekziston mundësia e mos realizimit të procedurave të prokurimit dhe të mos realizimit dhe respektimit të afatit kohor të kontratave.
Rekomandimi	Gjatë detajimit të artikullit buxhetor 602 “Shpenzime dhe shërbime “ AREB Tiranë, të bëjë shpërndarje të barabartë të fondeve për prokurim në 4-mujore dhe në afatin e përmbushjes së kontratës, referuar VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

	publik”, i ndryshuar
Afati për zbatimin e rekomandimit	“Në vazhdimësi”
Statusi i rekomandimit	Pranuar

**Opinion i përgjithshëm:** Kontrolli i brëndshëm ka qenë efektiv në fushën e planifikimit të fondeve, të hartimit të regjistrimit të prokurimeve publike dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, por ka nevojë për një planifikim dhe shpërndarje më të barabartë të fondeve për tu prokuruar në 4-mujore.

#### 4. Auditimi i disponibilitetit të fondeve buxhetore për financimin e zbatimit të projekteve të ndryshme, të investimeve, apo shërbimeve në vitin ushtrimor dhe atyre që zgjasin në vitet në vazhdim, përpara se të fillojë procedura e prokurimit publik.

##### Disponibiliteti i fondeve

Areb Tiranë, është institucion buxhetor në varësi të MBZHR dhe ushtron aktivitetin e saj në Qarkun Tiranë, Dibër dhe Durrës. Aktiviteti Areb Tiranë financohet nga buxheti i shtetit për pagat e punonjesve, të kontributit të sigurimeve shoqërore, të shpenzimeve operative dhe fondet e ka të garantuara me ligj. Areb disponon të gjitha burimet financiare për ushtrimin e aktivitetit dhe disponon fondet e nevojshme për pagesën e kontratave të blerjeve, shërbimeve dhe të punëve publike. Përpara se të fillojë procedura e prokurimit publik, AREB Tiranë për financimin e zbatimit të projekteve të ndryshme, të investimeve, apo shërbimeve në vitin ushtrimor dhe atyre që zgjasin në vitet në vazhdim, disponon burimet financiare të miratuara dhe të planifikuara për financim.

Fondet buxhetore për financimin e programit për bujqësinë, të zbatimit të projekteve të ndryshme, për blerje, shërbime e investime shoqërohen me projektin përkatës dhe janë të detajuara në planin e financimit dhe në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike në vitin ushtrimor. Për vitin 2019 me shkresën nr 24/2 prot. datë 08.01.2019 dhe për vitin 2020 me shkresën nr 312 prot. datë 15.01.2020, AREB Tiranë, është financuar nga buxheti i shtetit për shpenzime operative përkatësisht për vitin 2019 në shumën prej 8.500 mijë lekë, ndërsa për vitin 2020 është financuar për shumën 10.000 mijë lekë. Pas financimit është bërë detajimi i fondeve në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për shpenzime operative për blerje e shërbime.

Referuar situacionit përfundimtar të shpenzimeve të konfirmuara nga Dega e Thesarit Tiranë rezulton se nga auditimi i përshkrimit të planifikimit dhe realizimit të fondeve nga AREB Tiranë fondet janë akoduar për shpenzime transporti, të siguracionit të mjeteve të transportit, për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, për blerje tonera, kancelari, për mirëmbajtjen e aparateve dhe pajiseve teknike, bleje pjesë këmbimi, materiale zyre dhe të përgjithshme, materiale për pastrim dizifektim, etj

Me shkresë të MBZHR-së nr. 312 prot. datë 15.01.2020 AREB Tiranë është financuar nga buxheti i shtetit për shpenzime për paga të punonjëse, sigurime shoqërore, shpenzime operative, për mallra e shërbime dhe investime, në shumën prej 57.949 mijë lekë, ndërsa në vitin 2020 është financuar për 65.195 mijë lekë.

Me shkresë të AREB Tiranë nr. 271/4 datë 25.03.2020 është dërguar në MBZHR shtesë regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit publik për prokurimin me objekt “Blerje pajisje kompjuterike” me fond limit në shumën 1.250.000 lekë pa tvsh (1.500.000 lekë me tvsh). Kjo procedurë prokurimi është e përqëndruar dhe është realizuar nga AKSHI në shumën 1.161.120 me tvsh.

Nga auditimi i regjistrimit të realizimit të prokurimeve publike për 8 mujorin e vitit 2020, rezultoi se AREB Tiranë ka realizuar 10 procedura prokurimi nga 13 të parashikuara, në shumën 3.008.991 lekë me tvsh. Realizimi i fondeve është në proces.

Realizimi i fondeve si 9 mujor paraqitet në shumën prej 42.041 mijë lekë, nga 50.595 mijë lekë të planifikura.

**5. Auditimi i regjistrimit, evidentimit në kontabilitet, si dhe Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) të Degës së Thesarit të detyrimeve të prapambetura dhe të shtesave të kontratave. Verifikimi i dokumentacionit mbështetës dhe procedurave për përfshirjen e detyrimeve financiare në listën e shlyerjes së tyre.**

**Regjistrimi dhe kontabilizimi.**

AREB nuk ka patur detyrime financiare të konstatuara deri më 30.09.2020, por gjatë rishikimit janë konstatuar dy kreditorë të cilët kanë paraqitur dokumentacionin dhe për AREB Tiranë ka lindur detyrimi financiar për dy subjekte.

Pas konstatimit të detyrimeve financiare nëpërmjet rishikimit zyra e financës ka bërë regjistrimin dhe kontabilizimin e kreditorit:

1. Bailiff shpk, në shumën prej 1.098.544 lekë.
2. Shpëtim Allamani, në shumën prej 1.107.098 lekë.

Rregjistrimi i detyrimeve të konstatuara gjatë vitit ushtrimor është bërë sipas radhës të lindjes së detyrimit (formati 5) në përputhje me ligjin nr 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**Kontabilizimi i veprimit:**

1. Debituar llogaria 6027 “Shpenzime për detyrime për kompesime legale”, për shumën 1.098.544 lekë, në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën 1.098.544 lekë.  
Debituar llogaria 6027 “Shpenzime për detyrime për kompesime legale”, për shumën 1.107.098 lekë, në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën 1.107.098 lekë. Për të dy rastet regjistrimi dhe kontabilizimi i likuidimit të vendimeve gjyqësore është bërë jo në regjistrat kontabël, sic përcaktohet në ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, por në format të veçantë.

**Regjistrimi në kontabilitet i detyrimeve të prapambetura**

Subjekti i audituar	AREB Tiranë, nëpunësi autorizues zbatues
Njesitë, subjektet e interesuara nga gjetja	AREB Tiranë MBZHR
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Udhëzimi për menaxhimin e aseteve në Sektorin Publik.
Përshkrim i gjetjes	<b>Situata:</b> AREB Tiranë, nuk rezultoi me detyrime financiare të prapambetura, të konstatuara deri më 30.09.2020, për pasojë nuk është evidentuar asnjë rast regjistrimi në kontabilitet i detyrimeve financiare, por në vitin 2019, është konstatuar detyrimi ndaj 1. Bailiff shpk, në shumën prej 1.098.544 lekë. 2. Shpëtim Allamani, në shumën prej 1.107.098 lekë. Rregjistrimi i detyrimeve të konstatuara gjatë vitit ushtrimor është bërë sipas radhës të lindjes së detyrimit (formati 5) në përputhje me ligjin nr 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

	<p><b>Kontabilizimi i veprimit:</b></p> <p>1. Debituar llogaria 6027 “Shpenzime për detyrime për kompesime legale”, për shumën 1.098.544 lekë, në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën 1.098.544 lekë.</p> <p>Debituar llogaria 6027 “Shpenzime për detyrime për kompesime legale”, për shumën 1.107.098 lekë, në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën 1.107.098 lekë <b>Për të dy rastet</b> regjistrimi dhe kontabilizimi i likuidimit të vendimeve gjyqësore është bërë jo në regjistrat kontabël, sic përcaktohet në ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, por në format të veçantë.</p> <p><b>Kriteri:</b> Neni 3, pika 1 e ligjit nr 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</p> <p><b>Ndikimi/efekti:</b> Nuk mundëson detyrimin e AREB Tiranë për kontrollin e efektivitetit të fondeve, si edhe mbajtjen e azhurnimit të databasës për vendimet gjyqësore të formës së prerë, referuar pikës 4 të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr 1 datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarrit</p> <p><b>Shkaku:</b> Nuk janë respektuar procedurat e regjistrimit kronologjik në ditat e veprimeve dhe fakteve ekonomike.</p>
Niveli i rrishtit:	<b>i mesëm</b>
Konkluzioni	Për shkak të mos regjistrimit dhe kontabilizimit të veprimeve ekonomike, nuk evidentohet detyrimi financiar i vendimeve gjyqësore të likuiduar, si edhe nuk bëhet i mundur mbajtja e databasës për vendimet gjyqësore të formës së prerë.
Rekomandimi	Regjistrimi dhe kontabilizimi i veprimeve ekonomike, që kanë të bëjnë me likuidimin e detyrimeve ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të bëhet në regjistrat kontabël të miratuara, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit nr 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
Afati për zbatimin e rekomandimit	“Në vazhdimësi”
Statusi i rekomandimit	Pranuar

**Opinionimi i përgjithshëm:** Kontrolli i brendshëm ka qenë efektiv në fushën e mbajtjes së kontabilitetit dhe krijimit të databasës për vendimet gjyqësore të formës së prerë. Ka nevojë për përmirësime në fushën e regjistrimit dhe kontabilizimit të veprimeve ekonomike, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

**Evidentimi në sistemin informatik Financiar të Qeverisë SIFQ**

AREB Tiranë, nuk ka akses në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), por të gjitha të dhënat mbi aktivitetin financiar i evidenton nëpërmjet Degës së Thesarit Durrës, si për detyrimet e prapambetura, ashtu edhe për shtesat e kontratave.

Nga auditimi u konstatua se AREB Tiranë nuk ka akses për regjistrimin e detyrimeve të prapambetura dhe të shtesave të kontratave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) të Degës së Thesarit Tiranë

**Aksesimi i të dhënave për detyrimet prapambetura dhe të shtesave të kontratave, në sistemin SIFQ.**

Subjekti i audituar	Areb Tiranë, nëpunësi autorizues zbatues dhe juristi
Njesitë, subjektet e interesuara nga gjetja	Areb Tiranë MBZHR
Përmbledhja e bazës ligjore	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 37, datë 6.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi II.
Përshkrim i gjetjes	Areb Tiranë, nuk ka akses në publikimin e të dhënave të kontratave dhe të shtesës së kontratave në Sistemin Informatik Financiar Shtetëror. Aktiviteti i Areb Tiranë është i konsiderueshëm dhe i rëndësishëm në fushën e prodhimit bujqësor. Për këto arsye, publikimi i të dhënave të kontratatave dhe të shtesave të kontratave do të rriste transparencën nëpërmjet monitorimit të veprimtarisë së AREB Tiranë.
Niveli i riskut:	<b>i mesëm</b>
Konkluzioni	Për shkak të mos publikimit të të dhënave të shtesave dhe kontratave, rriten kostot e publikimit në agjenci të tjera me pagesë si edhe minimizohet mundësia e monitorimit dhe transparencës
Rekomandimi	Areb Tiranë, të bashkëpunojë me MBZHR-në për të patur akses në publikimin e të dhënave, si detyrime financiare të prapambetura dhe shtesa kontratash në sistemin SIFQ, pranë degës së thesarit Tiranë, referuar Udhëzimit të MFE nr. 37, datë 6.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi II.
Afati për zbatimin e rekomandimit	“Menjëherë”
Statusi i rekomandimit	Pranuar

**Opinion i përgjithshëm:** Kontrolli i brendshëm ka qenë efektiv në fushën e evidentimit të të dhënave mbi detyrimet financiare. Ka nevojë për bashkëpunim më të ngushtë me SIFQ për të patur akses në publikim të dhënash si edhe në monitorimin e të dhënave të publikuara.

**Verifikimi i dokumentacionit** mbështetës dhe procedurave për përfshirjen e detyrimeve financiare në listën e shlyerjes së tyre.

Nga verifikimi u konstatua se për të dy rastet proceduat e përfshirjes së tyre në listën e detyrimeve janë të plota dhe të shoqeruara me dokumentacion mbështetës justifikues

*Regjistrimi/evidentimi në SIFQ i Degës së Thesarit*

Subjekti i audituar	Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse,
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AREB Tiranë MBZHR, MFE
Përmbledhja e bazës ligjore	Udhëzimet Plotësuese të zbatimit të buxhetit vjetor; Udhëzimi nr. 37 datë 6.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.
Përshkrim i Gjetjes	<b>Situata:</b> Për procesin e regjistrimit në SIFQ mungon rakordim periodik midis AREB dhe Degës së Thesarit në lidhje me statusin e detyrimeve të prapambetura që janë të regjistruara në SIFQ, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës, me qëllim garantimin e raportimit të saktë periodik të njësive shpenzuese në Sektorin e Buxhetit në MBZHR të detyrimeve të prapambetura dhe të krijuara rishtazi dhe ato në MFE nga Dega e Thesarit. <b>Kriteri:</b> Udhëzimit nr. 37 datë 6.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimet Plotësuese të zbatimit të buxhetit vjetor; <b>Ndikimi/Efekt:</b> nuk ka efekt financiar; mosgarantim i raportimit të saktë të dhënave të SIFQ me ato që raportohen nga ministria. <b>Shkaku:</b> mos vendosje rregullash shtesë në shkëmbimin e informacioneve për detyrimet
Niveli i Riskut	I Lartë
Konkluzioni	Ka mospërputhje të dhënave të SIFQ me detyrimet në fakt si pasojë e mungesës së kontrolleve shtesë në evidentimin dhe rakordimin e detyrimeve.
Rekomandim	Të bëhet rakordim periodik midis njësisë shpenzuese dhe Degës së Thesarit në lidhje me statusin e detyrimeve të prapambetura që janë të regjistruara në SIFQ, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës, para raportimit periodik të njësive shpenzuese në Sektorin e Buxhetit në MBZHR të detyrimeve të prapambetura dhe të krijuara rishtazi.
Afati i fundit zb.rek	<i>Menjëherë dhe në vazhdim</i>
Statusi rekomandimit	<b>Pranohet</b>

**Opinion i përgjithshëm:** Nevojitet përmirësim në drejtim të raportimit/ regjistrimit dhe rakordimit sipas rekomandimit të dhënë afateve të përcaktuara në degën e thesarit dhe në MBZHR.

**6. Verifikimi i respektimit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për secilën kategori, sipas parimit të radhës kohore të krijimit të detyrimit financiar dhe sipas sektorëve.**

Nga auditimi i dy procedurave të detyrimeve financiare të konstatuara e konkretisht:

1. Bailiff shpk, në shumën prej 1.098.544 lekë

2. Shpëtim Allamani, në shumën prej 1.107.098 lekë

rregjistrimi i detyrimeve të konstatuara gjatë vitit ushtrimor është berë sipas radhës të lindjes së detyrimit parimit kohor (formati 5).

**II. Monitorimi i zbatimit të buxhetit**

Në zbatim të Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 37, datë

6.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore” AREB Tiranë, në fund të çdo muaji dhe progresiv ka hartuar raportin e realizimit të shpenzimeve (Situacionin) dhe një kopje e ka dorëzuar në MBZHR dhe degën e Thesarit Tiranë.

Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit, ndiqet nga nëpunësi zbatues në mënyrë periodike dhe progresive

Dega e financës ka hartuar në fund të çdo muaji situacionet periodike mujore, progresive duke evidentuar të dhënat mbi financimin dhe realizimin e fondeve. Gjithashtu referuar shtojcës 3, është bërë raportimi mbi detyrimet e prapambetura deri në përiudhën raportuese.

### 1. Hartimi i planit të shlyerjes detyrimeve të prapambetura për vitin korrent e afatmesëm. Përgatitja e planit masave për parandalimin e krijimit të detyrimeve në të ardhmen.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2019, të regjistrit të prokurimeve publike, ditarit të bankës dhe dokumentacionit që administrojnë dega e financës rezultoi se AREB Tiranë nuk rezultoi me detyrime, e për pasojë nuk ka plan të shlyerjes detyrimeve të prapambetura për vitin korrent e afatmesëm (shtojca 3 “formati i raportimit të detyrimeve të prapambetura deri në 30.09.2020”).

### Hartimi i planit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin korrent e afat mesëm

Subjekti i audituar	AREB Tiranë, nëpunësi autorizues zbatues
Njesitë, subjektet e interesuara nga gjetja	AREB Tiranë MBZHR
Përmbledhja e bazës ligjore	1. Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, ndryshuar. 2. Udhëzimet vjetore të zbatimit të buxhetit 3. Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”. 4. Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr 1 datë 4.6.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njesive të qeverisjes së përgjithëshme për llogari të thesarit”
Përshkrim i gjetjes	<b>Situata:</b> Janë konstatuar dy raste kreditore për shumat respektive 1.098.544 lekë dhe 1.107.098 lekë. Është bërë likuidimi i tyre, regjistrimi dhe kontabilizimi i veprimit. Për të dy rastet regjistrimi dhe kontabilizimi i likuidimit të vendimeve gjyqësore është bërë jo në regjistrat kontabël, sic përcaktohet në ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, por në format të veçantë <b>Kriteri:</b> pika 3, 4,7 e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr 1 datë 4.6.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njesive të qeverisjes së përgjithëshme për llogari të thesarit <b>Ndikimi/efekti:</b> Mos parashikimi i fondeve. mos likuidimi në afat i detyrimeve gjyqësore, mos hartimi i planit të masave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nuk mundësojnë marrëdhënie korrekte me kontraktorin për vonesat në likuidim aplikohen penalitete dhe në

	mënyrë fiktive rrit koston e blerjes/ shërbimit <b>Shkaku:</b> Nuk janë respektuar procedurat e ligjore për likuidimin e detyrimeve gjyqësore të formës së prerë, për shkak të mungesës së fondeve.
Niveli i rrishtit:	<b>i mesëm</b>
Konkluzioni	Mos hartimi i planit të masave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në vitin korrent dhe atë afat mesëm ka bërë që likuidimi të mos bëhet në afat, ka aplikim të penalteteve duke rritur kostot e shërbimit dhe ky veprim bëhet shkak për mos funksionimin normal të aktivitetit të subjektit.
Rekomandimi	AREB Tiranë të hartojë plan për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për vitin korrent dhe atë afat mesëm referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr 1 datë 4.6.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njesive të qeverisjes së përgjithëshme për llogari të thesarit”
Afati për zbatimin e rekomandimit	“Mejshherë”
Statusi i rekomandimit	Pranuar

**Opinion i përgjithshëm:** Kontrolli i brendshëm ka qenë efektiv në fushën e evidentimit dhe vlerësimit të vendimeve gjyqësore dhe të detyrimeve të tjera që kanë lindur, por ka nevojë që të bashkëpunohet më mirë për hartimin e planit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin korrent dhe atë afat mesëm.

### *Procedurat për parandalim detyrime*

Subjekti i audituar	Titullari/ Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse,
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AREB Tiranë MBZHR, MFE
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”; Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
Përshkrim i Gjetjes	<b>Situata:</b> 1. Mungon një rakordim periodik midis OSHEE dhe UK për ecurinë e shlyerjes së detyrimeve mujore dhe ekzistencës së detyrimeve e prapambetura të panjohura më parë. 2. Depozitimi i kërkesës për pagesë dhe faturave të mallrave, shërbimeve apo punëve nga operatorët ekonomik nuk protokollohet me qëllim që të formalizohet marrja në dorëzim e tyre dhe ndarja e përgjegjësive midis operatorit ekonomik dhe njësisë shpenzuese në raste të tejkalimit të afateve të pagesave. <b>Kriteri:</b> neni 7, Ligji Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 9 dhe 12, Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. <b>Ndikimi/Efekti:</b> mungesa e rakordimeve dhe protokollimit të kërkesave për likuidim të faturave sjell rritje të detyrimeve e prapambetura si dhe mos ndarje të përgjegjësive në krijimin e detyrimeve për shkak të likuidimeve me vonesë. <b>Shkaku:</b> Mos marrje e masave nga nëpunësi autorizues dhe zbatues për propozimin dhe vendosjen e kontrolleve shtesë të munguara.
Niveli i Riskut	I Lartë



Konkluzioni	Duhet shtuar kontrole për parandalimin e detyrimeve pasi rakordime periodike me OSHEE dhe UK dhe protokollimit të kërkesave të subjeteve kreditore për likuidim të faturave të mallrave, shërbimeve dhe punëve.
Rekomandim	<ol style="list-style-type: none"> <li>Të protokollohet depozitimi i kërkesës për pagesë dhe faturave të mallrave, shërbimeve apo punëve nga operatorët ekonomik me qëllim që të formalizohet marrja në dorëzim e tyre dhe ndarja e përgjegjësisë midis operatorit ekonomik dhe njësisë shpenzuese në raste të tejkalimit të afateve të pagesave.</li> <li>Të bëhen rakordime mujore me OSHEE për konsumimin e energjisë elektrike, UK për konsumimin e ujit duke ndikuar në shmangien e mbifaturimeve dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.</li> </ol>
Afati i fundit zb.rek.	<i>Menjëherë dhe në vazhdim</i>
Statusi rekomandimit	<b>Pranohet</b>

**Opinion i përgjithshëm:** Në përgatitjen e planit të masave për parandalimin e detyrimeve kanë funksionuar kontrollet por ka nevojë të vendosjes së kontrolleve shtesë në protokollimin e kërkesave të kreditorëve për likuidimin e faturave të shërbimeve, mallrave dhe punëve.

## 2. Verifikimi i raportimit periodik të monitorimit të performancës së buxhetit si dhe përgatitja e informacionit analitik mbi shlyerjen e detyrimeve prapambetura.

U auditua zbatimi i kërkesave të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit të shtetit”, Udhëzimit të MF nr.5 datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të zbatimit të buxhetit në njësisë të Qeverisjes Qëndrore”, si dhe udhëzimet vjetore të zbatimit të buxhetit për vitin 2019 dhe 2020.

Është bërë raportimi periodik mbi performancën e monitorimit të buxhetit nga nëpunësi zbatues i AREB Tiranë, pas rakordimit me degën e thesarit Tiranë, duke raportuar, dërguar çdo muaj në sektorin e buxhetit në MBZHR realizimin e shpenzimeve buxhetore sipas formatit të gjeneruar nga Sistemi SIFQ në përputhje me pikën 188 të Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit të shtetit”.

Në formatin e raportimit të shpenzimeve janë evidentuar programet, projektet, plani vjetor, plani i thesarit, shpenzime thesari etj.

**Raportimi** për çdo muaj i ka shërbyer sektorit të Buxhetit në MBZHR për përgatitjen e raportimeve 4-mujore dhe vjetore në përputhje me pikën 270 të Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit të shtetit” si dhe udhëzimit vjetor të zbatimit të buxhetit.

AREB Tiranë ka raportuar periodikisht në MBZHR, nëpërmjet nëpunësit zbatues mbi lindjen dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, sipas shtojcës nr.3 “Raportimi periodik i detyrimeve të prapambetura në njësitë të qeverisjes qendrore” dhe të shtojcës 3/1 “Skeduli i pagesave të detyrimeve të prapambetura” si dhe të udhëzimeve vjetore të zbatimit të buxhetit 2019, 2020, për detyrimet dhe marrjen e masave për planifikimin e likuidimit të tyre.

### *Raportimi periodik i detyrimeve*

Subjekti i audituar	Titullari/ Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse,
Njësitë/subjektet e interesuara nga	AREB Tiranë MBZHR, MFE

gjetja	
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”. Udhëzimet plotësuese të zbatimit të buxhetit vjetor
Përshkrim i Gjetjes	<b>Situata:</b> Nuk është bërë me shkresë zyrtare në MBZHR raportimi periodik i detyrimeve e shoqëruar me plotësimin e shtojcës nr.3 “Raportimi periodik i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore”, jo në përputhje me pikën 115 Kreu III-të të Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 20.1.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”. Në funksion të evidentimit, raportimit dhe shlyerjes së detyrimeve nuk është krijuar databaza për zbatimin e kontratave, afatet, personat përgjegjës, vonesat në zbatim, penaltitetet për vonesat dhe shlyerjen e detyrimeve të konstatuara, qëllim nxjerrjen e përgjegjësish. <b>Kriteri:</b> neni 7, Ligji Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” pika 115, Kreu III-të të Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 20.1.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”. <b>Ndikimi/Efekti:</b> Mos formalizim të informacionit të raportimit periodik të detyrimeve. <b>Shkaku:</b> Konsiderimi i raportimit të plotë vetëm me email dhe mos evidentimi i kësaj kërkesë nga MBZHR;.
Niveli i Riskut	I Lartë
Konkluzioni	Nuk bëhet raportim shkresor për detyrimet e prapambetuar dhe të krijuara rishtazi me plotësimin e shtojcave të udhëzimeve plotësuese të zbatimit të buxhetit vjetor; dhe mungon krijimi i databaza për evidentimin, raportimin dhe shlyerjen e detyrimeve.
Rekomandim	1. Raportimi i gjendjes së detyrimeve të prapambetura apo të krijuara rishtazi të bëhet me shkresë zyrtare i shoqëruar me shtojcën nr.3 “Raportimi periodik i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore”, dhe nr. 3/1 “Skeduli i pagesave të detyrimeve të prapambetura” të Udhëzimeve vjetore të zbatimit të buxhetit, për detyrimet dhe planifikimin e shlyerjes së tyre. 2. Të caktohet një specialist për krijimin e databazës, hedhjen e të dhënave deri në zbatimin përfundimtar të kontratave, në funksion të gjurmës së auditimit, saktësisë, plotësisë dhe transparencës së veprimeve të kryera në SIFQ.
Afati i fundit zb.rek.	<i>Menjëherë dhe në vazhdim</i>
Statusi rekomandimit	<b>Pranohet</b>

**Opinion i përgjithshëm:** Kontrollat e vendosura në raportimin e monitorimit të performancës së buxhetit dhe të krijimit të detyrimeve të prapambetura nga njësitë shpeznuese kanë funksionuar mbetet për përmirësim raportimi shkresor, plotësimi i shtojcave standarte të raportimit dhe krijimin e databazës për detyrimet.

### Rregjistri i Riskut

Subjekti i audituar	Titullari/Drejtoria e Teknologjive Bujqësore, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sek. Bazës Eksperimentale Prodhuese
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	AREB Tiranë MBZHR
Përmbledhja b.ligjore	Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; Manuali për MFK.
Përshkrim i Gjetjes	<b>Situata:</b> QTTB-ja përballet me risqe brenda dhe jashtë kontrollit menaxherial. Nuk ka përditësim të regjistrit të riskut. Është ngritur grupi për menaxhimin e riskut i cili ka bërë mbledhje për përditësimin e regjistrit të riskut për vitin 2019 dhe 2020 për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve.

	<p><b>Kriteri:</b> neni 11/2 i Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Nuk ka efekt financiar. Ndikon në realizimin e objektivave afatshkurtra e afatgjata me efektivitet e efikasitet.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e trajnimeve në këtë fushë.</p>
Niveli i Riskut	I mesëm
Konkluzioni	Menaxhimi i riskut kërkon përmirësim në përditësimin e risqeve të brendshëm dhe të jashtëm.
Rekomandim	Të identifikohen, vlerësohen risqet, të evidentohen masat për menaxhimin e tyre dhe të përditësohet regjistri i riskut.
Afati i fundit për zbatim rekomandimi	<i>Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar.</i> Auditimi sugjeron brenda muajit menjëherë e në vazhdim
Statusi rekomandimit	Ky status përmbledh <b>pranimin ose jo nga pala e audituar.</b> (Plotësohet mbas fazës së observacioneve)

**Opinion i përgjithshëm:** Ka analiza, evidentohen risqet, duhet përmirësim për përditësimin e regjistrit me proceset e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut.

#### V. KONKLUZIONE TË PËRGJITHSHME.

Në përfundim të misionit, grupi i auditimit konkludon me këtë vlerësim performance për Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë.

AREB nëpërmjet procedurave të krijuara nga aktet ligjore, administrative dhe rregulloren e brendëshme të Institucionit, ka kryer një monitorim, vlerësim mujor të punës së stafit në drejtim të realizimit të objektivave. Janë respektuar kërkesat ligjore në drejtim të :

- ✓ **Konstatimi i detyrimeve.** Nuk janë konstatuar detyrime financiare të prapambetura. Në rastin e detyrimeve financiare të lindura dhe të pranuar AREB Tiranë ka bërë vlerësimin e shumës financiare që i detyrohet palëve të treta duke respektuar afatin kohor të likuidimit të tyre, prej 60 ditëve kalendarik nga data e paraqitjes së faturës.
- ✓ **Evidentimi dhe rakordimi.** Pas konstatimit të detyrimit financiar AREB Tiranë, ka bërë evidentimin dhe rakordimin e shumës së konstatuar dhe ka nisur procedurat e vlerësimit dhe shlyerjes së detyrimit financiar.
- ✓ **Verifikimi i regjistrit** të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, është konstatuar se është hartuar në përputhje me të VKM nr 914 datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.
- ✓ **Disponibiliteti i fondeve.** Areb ka disponuar të gjitha burimet financiare të planifikuara për zbatimin e projekteve të ndryshme. MBZHR ka disponuar të gjitha burimet e nevojshme për mbështetjen financiare të projekteve, blerjeve dhe shërbimeve, investimeve etj.
- ✓ **Regjistrimi në kontabilitet,** i detyrimeve gjyqësore të konstatuara është bërë jo në regjistrat kontabël, siç përcaktohet në Ligjin nr 25 datë 10.05.2018 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, por në format të veçantë.
- **Areb Tiranë nuk ka akses** në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), pranë Degës së Thesarit Tiranë.
- **Hartimit të planit të shlyerjes detyrimeve** të prapambetura për vitin korrent e afatmesëm. MBZHR nuk rezulton me detyrime financiare të prapambetura të pa

likuiduara, por me detyrime të konstatuara për të cilat në fillim të çdo viti ushtrimor ka bërë evidentimin dhe raportimin e tyre).

- **Verifikimit të raportimit periodik të monitorimit të performancës së buxhetit** si dhe përgatitja e informacionit analitik mbi shlyerjen e detyrimeve prapambetura.

### **Vlerësimi i mjedisit të përgjithshëm të kontrollit.**

Referuar procedurave të “Manualit të Auditimit të Brendshëm”, auditimit të kryer, vlerësojmë se procedurat e vlerësimit, evidentimit dhe të likuidimit të detyrimeve gjyqësore të prapambetura janë bërë në përputhje me lindjen e detyrimit, programin, strukturën buxhetore, dokumentacionin mbështetës që është paraqitur, duke respektuar afatin kohor dhe janë të dokumentuara. Duke gjykuar dhe nga konstatimet e mësipërme të evidentuara në aktin e verifikimit, nga auditi “Mjedisi i përgjithshëm i kontrollit” **vlerësohet me nivel të mesëm të riskut.**

Këto ishin sa u konstatuan nga akti i verifikimit i mbajtur me date 11.12.2020 në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë.

### **VI. REKOMANDIME PËR PLANIN E VEPRIMIT**

Mbështetur në nenin 16 të ligjit nr 114, 22.10.2015” Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” pika 4 dhe 5 “Raportimi dhe Komunikimi i Auditimit, Sigurimi i Cilësisë së Punës të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm “ i ndryshuar, për përmirësimin e mangësive të konstatuara, rritjen e nivelit të punës të administratës, auditimi ka dhënë rekomandime në Aneksin nr. 1 “PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE” të këtij Raporti.

**Të analizohet materiali i auditimit, të hartohet plan veprimi dhe të caktohet një punonjës me përvojë për të monitoruar progresin në bërë në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.**

Grupi i auditimit **vlerëson** se zbatimi i rekomandimeve do të ndikojë në arritjen e objektivave të institucionit, në zbatimin më të mirë të dispozitave ligjore, ndërkohë që menaxhimi i institucionit duhet të llogarisë dhe të marrë përsipër koston negative, rrisqet që mund të shkaktojë mos zbatimin e tyre.

### **VII. FALENDERIMET**

Për plotësimin e misionit të auditimit, grupi i punës falenderon Drejtorin dhe stafin e Drejtorisë së Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Tiranë Z. Veis Selami, Përgjegjësën e Sektorit të Financave znj. Drita Nikuçi, pr gadishmërinë e plotë që treguan për vënien në dispozicion të dokumentacionit, krijimin e kushteve të punës, bashkëpunimin gjatë gjithë kohës së auditimit dhe trajtimin e problemeve të konstatuara nga grupi i auditimit.

**Raporti për auditimin e ushtruar mbahet në tre kopje, dy kopje i dorëzohen zyrtarisht subjektit të audituar dhe duhet t’i vihet në dispozicion të gjithë stafit të Institucionit.**

*Veis Selami*  
*Drita Nikuçi*

**GRUPI I AUDITIMIT;**  
**1. RESHIT HAKA**  
**2. ADRIANA NASI**



## Aneksi Nr.1

## PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

Nr.	Rekomandimet	Niveli Riskut
<b>I.</b>	<b>Për përmirësimin e sistemeve</b>	
1	Raportimi i gjendjes së detyrimeve të prapambetura apo të krijuara rizhtazi të bëhet me shkresë zyrtare i shoqëruar me shtojcën nr.3 "Raportimi periodik i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore", dhe nr. 3/1 "Skeduli i pagesave të detyrimeve të prapambetura" të Udhëzimeve vjetore të zbatimit të buxhetit, për detyrimet dhe planifikimin e shlyerjes së tyre.	I Lartë
2	Të bëhet rakordim periodik midis njësisë shpenzuese dhe Degës së Thesarit në lidhje me statusin e detyrimeve të prapambetura që janë të regjistruara në SIFQ, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës, para raportimit periodik të njësisë shpenzuese në Sektorin e Buxhetit në MBZHR të detyrimeve të prapambetura dhe të krijuara rishtazi.	I Lartë
3	Të protokollohet depozitimi i kërkesës për pagesë dhe faturave të mallrave, shërbimeve apo punëve nga operatorët ekonomik me qëllim që të formalizohet marrja në dorëzim e tyre dhe ndarja e përgjegjësisë midis operatorit ekonomik dhe njësisë shpenzuese në raste të tejklimit të afateve të pagesave.	I Lartë
4	Të bëhen rakordime mujore me OSHEE për konsumimin e energjisë elektrike, UK për konsumimin e ujit duke ndikuar në shmangien e mbifaturimeve dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.	I Lartë
5	Të caktohet një specialist për krijimin e databazës, hedhjen e të dhënave deri në zbatimin përfundimtar të kontratave, në funksion të gjurmës së auditimit, saktësisë, plotësisë dhe transparencës së veprimeve të kryera në SIFQ	I Lartë
6	Të identifikohen, vlerësohen risqet, të evidentohen masat për menaxhimin e tyre dhe të përditësohet regjistri i riskut.	I Lartë
<b>I.</b>	<b>Për masa organizative</b>	
1	Gjatë detajimit të artikullit buxhetor 602 "Shpenzime dhe shërbime "AREB Tiranë, të bëjë shpërndarje të barabartë të fondeve për prokurim në 4-mujore dhe në afatin e përbushjes së kontratës, referuar VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar	I mesëm
2	Regjistrimi dhe kontabilizimi i veprimeve ekonomike, që kanë të bëjnë me likuidimin e detyrimeve ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të bëhet në regjistrat kontablie të miratuara, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit nr 25 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"	I Mesëm

## Aneksi Nr.2

## OBSERVACIONET

Observacioni i gjetjes	Për gjetjet dhe rekomandimet e evidentuara në aktin e verifikimit nuk janë bërë vërejtje apo sugjerime nga përfaqësuesit e AREB Tiranë
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Gjetjet dhe rekomandimet mbeten të pandryshuara
Rishikimi i statusit të gjetjes	Nuk ndryshon

Rishikimi i nivelit të riskut	Nuk ndryshon
-------------------------------	--------------

**PLAN VEPRIMI I SUGJERUAR PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE  
AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR, TIRANË**

Nr Rek	Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit Në Raport	Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
1.	<b>Për përmirësimin e sistemeve</b>					
1	Raportimi i gjendjes së detyrimeve të prapambetura apo të krijuara rrizhazazi të bëhet me shkresë zyrtare i shoqëruar me shtojcën nr.3 “Raportimi periodik i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore”, dhe nr. 3/1 “Skeduli i pagesave të detyrimeve të prapambetura” të Udhëzimeve vjetore të zbatimit të buxheut, për detyrimet dhe planifikimin e shlyerjes së tyre.	I Lartë	Pika II.2 Faqe 15		Menjherë e në vazhdim	Drejtori, Nëpunësi Zbatues
2	Të bëhet rakordim periodik midis njësisë shpenzuese dhe Degës së Thesarit në lidhje me statusin e detyrimeve të prapambetura që janë të regjistruara në SIFQ, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës, para raportimit periodik të njërive shpenzuese në Sektorin e Buxheut në MBZHR të detyrimeve të prapambetura dhe të krijuara rrizhazazi.	I Lartë	Pika I.5 Faqe 12		Menjherë e në vazhdim	Drejtori, Nëpunësi Zbatues
3	Të protokollohet depozitimi i kërkesës për pagesë dhe faturave të mallrave, shërbimeve apo punëve nga operatorët ekonomik me qëllim që të formalizohet marrja në dorëzim e tyre dhe ndarja e përgjegjësiive midis operatorit ekonomik dhe njësisë shpenzuese në raste të tejaktimit të afateve të pagesave.	I Lartë	Pika II.1 Faqe 14-15		Menjherë e në vazhdim	Drejtori, Nëpunësi Zbatues.
4	Të bëhen rakordime mujore me OSHEE për konsumimin e energjisë elektrike, UK për konsumimin e ujit duke ndikuar në shmangjen e mbifaturimeve dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.	I Lartë	Pika /II.1 Faqe 14-15		Menjherë e në vazhdim	Drejtori, Nëpunësi Zbatues
5	Të caktohet një specialist për krijimin e databazës, hedhjen e të dhënave deri në zbatimin përfundimtar të kontratave, në funksion të gjurmës së auditimit, sakrësisë, plotësisë dhe transparencës së veprimeve të kryera në SIFQ	I Lartë	Pika II.2 Faqe 15		Menjherë e në vazhdim	Drejtori, Nëpunësi Zbatues
6	Të identifikohen vlerësohen risqet, të evidentohen masat për menaxhimin e tyre dhe të përditësohet regjistri i	I Lartë	Pika II.2 Faqe 15-16		Menjherë e në vazhdim	Drejtori, Nëpunësi Zbatues.

	riskut.					pergjegjesit e sektoreve
<b>I. Për masa organizative</b>						
1	Gjatë detajimit të artikullit buxhetor 602 "Shpenzime dhe shërbime "AREB Tiranë, të bëjë shpërndarje të barabartë të fondeve për prokurim në 4-mujore dhe në afatin e përbushjes së kontratës, referuar VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar	I mesëm	Faqe 7,8.,pika 3		Në vazhdimësi	Drejtori, nëpunësi zbatues
2	Regjistrimi dhe kontabilizimi i veprimeve ekonomike, që kanë të bëjnë me likuidimin e detyrimeve ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të bëhet në regjistrat kontabile të miratara, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit nr 25 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"	I Mesëm	Faqe 10, pika 5		Në vazhdimësi	Nëpunësi zbatues
3	AREB Tiranë të hartojë plan për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për vitin korrent dhe atë afat mesëm referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr 1 datë 4.6.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njesive të qeverisjes së përgjithshme për llogari të thesarit"	I Mesëm	Faqe 13, pika 11/1		Menjëherë	Nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues
4	Areb Tiranë, të bashkëpunojë me MBZHR-në për të paturit publikimin e të dhënave, si detyrime financiare të prapambetura dhe shtesa kontratash në sistemin SIFQ, pranë degës së thesarit TiranëDurrës, referuar Udhëzimit të MFE nr. 37, datë 6.11.0.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme", paragrafi II.	Mesëm	Faqe 11, pika 5		Menjëherë	Nëpunësi zbatues, nëpunësi autorizues
5	Të merren masa në vazhdimësi për mbajtjen në funksionalitet të plotë të sistemeve të kontrollit të brendshëm si parandalues të situatave që krijojnë detyrime të prapambetura dhe paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, pasi për shkeljen e afateve të dorëzimit të faturave brenda afatit 30 ditor, të cilat dorëzohen me vonesë në zyrën e financës merren masa në përputhje me kërkesat e nenit 51 "Menaxhimi i Angazhimeve" dhe	I Lartë	Faqe 14-15, puka 11/1		Në vazhdimësi	Drejtori, Nëpunësi Zbatues



	nenit 71 “Kundravajtjet administrative” të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, të ndryshuar si dhe akteve nënligjore në fuqi, si raste më shkelje të procedurave për disiplinimin fiskal.					
6	Të analizohet materiali i auditimit, të hartohet plan veprimi dhe të caktohet një punonjës me përvojë për të monitoruar progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.	I Lartë	Manuali i Auditimit		Menjêherë e në vazhdim	Drejtori, Nëpunësi Zbatues, specialisti ngarkuar

**Për grupin e Auditimit të MBZHR**

Përgjegjës grupi

Anëtar grupi

Reshit Haka

Adriana Nasi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQESOR TIRANE

Nr. 190/prot.

Tiranë, më 22. 01.2021

Lënda: Reagim për Raportin Përfundimtar të Auditimit

**- MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**Drejtoria e Auditimit të Brëndshëm**  
**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.10487/4 prot. datë 30.12.2020 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe reagimet për auditimin”, ju informojmë se materiali është punuar me të gjithë Përgjegjësat e Sektorëve, të cilët janë dakort me gjetjet gjatë auditimit dhe me Planin e Veprimit të sugjeruar.

Ju falenderojmë për punën që keni bërë dhe bashkëpunimin me ne gjatë kohës së auditimit. Shprehemi dakort me Raportin e Auditimit,

Bashkëlidhur keni:

1. Raportin Përfundimtar të firmosur
2. Planin e veprimit
3. Reagimet për auditimin

*Duke ju falenderuar për mirëkuptimin*

Konceptoi: Drita Zdrava

**DREJTORI**  
**Veis Selami**



**Subjekti i audituar:** Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor Tirane

**Angazhimi i auditimit:** Auditim i kombinuar, performance, përputhshmërie dhe financiar.

**Data e Raportimit:** 30.12.2020

Ju lutemi siguroni feedback në përvojën tuaj të fundit me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm duke zgjedhur një nga katër listimet e mëposhtme:

Shumë të kënaqur, Të kënaqur, Të pakënaqur, Shumë të pakënaqur.

Duke përdorur shkallën e vlerësimit si më poshtë, ju lutem rrethoni numrin në kolonën e djathtë që reflekton pikëpamjet tuaja në punën tonë në secilën nga fushat e përmendura.

Në qoftë se jepet një vlerësim 3 ose 4, ju lutem jepni më shumë hollësi në seksionin "Komente" në mënyrë që ne të mund të marrim parasysh si mund të përmirësohemi.

*(Formulari plotësohet me pjesëmarrjen e stafit që ka patur kontakte me grupin e auditimit)*

<b>Shkalla e vlerësimit</b>					
<b>1 - Shumë të kënaqur</b>	<b>2 – Të kënaqur</b>	<b>3 – Të pakënaqur</b>	<b>4 – Shumë të pakënaqur</b>		
<b>KOMPONENTËT E PERFORMANCËS</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>Komente</b>
<b>PLANIFIKIMI I AUDITIMIT</b>	X				
Sa të kënaqur jeni që :					
1. Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushë veprimin e auditimit para se të fillonte?	X				
2. Ju është dhënë njoftimi i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit?	X				
<b>KRYERJA E AUDITIMIT</b>	X				
Deri në çfarë mase jeni të kënaqur që:					
3. Audituesit e brendshëm kanë qenë profesionalë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes të auditimit?	X				
4. Audituesit e brendshëm kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimitarisë tuaj?	X				
5. A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhimit auditimit duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan?	X				
<b>RAPORTIMI I REZULTATEVE TË AUDITIMIT</b>	X				
Sa të kënaqur jeni që:					
6. Projekt-raporti është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar? <i>Data e përfundimit të punës në terren: 24.12.2020</i> <i>Data e lëshimit të raportit paraprak: 24.12.2020</i>	X				
7. Projekt raporti është prezantuar në mënyrë të qartë në lidhje me formatin dhe qartësinë e gjuhës së përdorur?	X				
8. Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet raporti Përfundimtar është marrë brenda një kohe të					

pranueshme të parashikuar? <i>Data e marrjes se komenteve: 24.12.2020</i> <i>Data e lëshimit te raportit final: 30.12.2020</i>	X				
9. Rekomandimet ofruan zgjidhje praktike e konstruktive për çështjet e identifikuar? 10. Argumentimi për gjetjet dhe përfundimet e auditimit a janë shpjeguar në mënyrë të kënaqshme, komentet/ pikëpamjet tuaja a janë marrë parasysh?	X				
<b>CILËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM</b>  Sa të kënaqur jeni që:	X				
11. Zbatimi i rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të risqeve ,të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes?	X				
12. Auditimi ju ofroi informacionin që do t'ju ndihmojë për të përmbushur përgjegjësitë e raportimit tuaj të sigurimit të cilësisë?	X				
13. AB a kontribuon në përmirësimin organizativ për arritjen e objektivave strategjike në institucionin tuaj?	X				
<b>SHËRBIME TË TJERA TË OFRUARA NGA AUDITIMI I BRENDSHËM</b>	X				
14. A jeni të vetëdijshëm se Drejtorja e auditimit të brendshëm ofron shërbime këshillimi? 15. Nëse keni përdorur shërbimet e këshillimit të ofruara nga auditimi i brendshëm, a jeni të kënaqur me kontributin e dhënë?	X				

**DREJTOR**

**Veis Selami**



**PLAN VEPRIMI PER ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE  
AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR, TIRANË**

<b>Nr Rek</b>	<b>Rekomandimet</b>	<b>Renditja sipas niveelit</b>	<b>Referenca e paragrafit Në Raport</b>	<b>Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar</b>	<b>Afati i përcaktuar</b>	<b>Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve</b>
<b>I.</b>	<b>Për përmirësimin e sistemeve</b>					
1	Raportimi i gjendjes së detyrimeve të prapambetura apo të krijuara rishhazi të bëhet me shkresë zyrtare i shoqëruar me shtojcën nr.3 “Raportimi periodik i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore”, dhe nr. 3/1 “Skeduli i pagesave të detyrimeve të prapambetura” të Udhëzimeve vjetore të zbatimit të buxhetit, për detyrimet dhe planifikimin e shlyerjes së tyre.	II Lartë	Pika II.2 Faqe 15		Menjêherë e në vazhdim	Veis Selami Drita Nikoçi
2	Të bëhet rakordim periodik midis njësisë shpenzuese dhe Degës së Thesarit në lidhje me statusin e detyrimeve të prapambetura që janë të regjistruara në SIFQ, shoqëruar me dokumentacionin mbështetës, para raportimit periodik të njësisë shpenzuese në Sektorin e Buxheit në MBZHR të detyrimeve të prapambetura dhe të krijuara rishhazi.	II Lartë	Pika I.5 Faqe 12		Menjêherë e në vazhdim	Veis Selami Drita Nikoçi
3	Të protokollohet depozitimi i kërkesës për pagesë dhe faturave të mallrave, shërbimeve apo punëve nga operatorët ekonomik me qëllim që të formalizohet marrja në dorëzim e tyre dhe ndarja e përgjegjësisë midis operatorit ekonomik dhe njësisë shpenzuese në raste të tejakullimit të afateve të pagesave.	II Lartë	Pika II.1 Faqe 14-15		Menjêherë e në vazhdim	Veis Selami Drita Nikoçi
4	Të bëhen rakordime mujore me OSHEE për konsumimin e energjisë elektrike, UK për konsumimin e ujit duke ndikuar në shmangien e mbifaturimeve dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.	II Lartë	Pika /II.1 Faqe 14-15		Menjêherë e në vazhdim	Veis Selami Drita Nikoçi
5	Të caktohet një specialist për krijimin e databazës, hedhjen e të dhënave deri në zbatimin përfundimtar të kontratave, në funksion të gjurmës së auditimit, saktësisë, plotësisë dhe transparencës së veprimeve të kryera në SIFQ	II Lartë	Pika II.2 Faqe 15		Menjêherë e në vazhdim	Veis Selami Drita Nikoçi
6	Të identifikohen, vlerësohen risqet, të evidentohen masat për menaxhimin e tyre dhe të përditësohet regjistri i riskut.	II Lartë	Pika II.2 Faqe 15-16		Menjêherë e në vazhdim	Veis Selami Drita Nikoçi Përgjegjësit e sektoreve

<p>datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, të ndryshuar si dhe akteve nënligjore në fuqi, si raste më shkelje të procedurave për disiplinimin fiskal.</p>	<p>I Lartë</p>	<p>Manuali i Auditimit</p>		<p>Menjërherë e në vazhdim</p>	<p>Veis Selami Drita Nikoçi</p>
<p>6 Të analizohet materiali i auditimit, të hartohet plan veprimi dhe të caktohet një punonjës me përvojë për të monitoruar progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.</p>					

**DREJTORI**  
**Veis Selami**

